

SHKOLLAT E MESME PEDAGOGJIKE

PJESA I - GJUHË SHQIPE

1. Qarko ndërtimin në të cilin fjala *bukë* është përdorur në kuptimin e saj të parë. **1 pikë**
A) Në atë moment kafshoi nxitimthi një copë bukë.
B) Punuam në kurbet për bukën e gojës.
C) Misri sapo kishte zënë bukë.
D) Gjithnjë ngrihem nga buka pa u ngopur.
2. Qarko ndërtimin që është fjalë e urtë. **1 pikë**
A) Ia merr pula bukën nga dora.
B) Buka që thyhet, nuk ngjitet më.
C) Sikur i ka ngrënë gomari bukën.
D) E kishte ngrënë turpin me bukë.
3. Shkruaj kuptimin e kësaj shprehjeje: **1 pikë**
E ka ngrënë turpin me bukë.
4. Shkruaj një fjalë të prejardhur nga tema fjalëformuese *besë*. **1 pikë**

5. Gjej përbërësit e fjalës *i pakujdesshëm*. **3 pikë**
a. rrënja _____
b. parashtesa _____
c. prapashtesa _____
6. Nënvizoj fjalën e futur gabim në grupin e fjalëve të përngjitura. **1 pikë**
A) megjithatë
B) bashkëbisedoj
C) njëmbëdhjetë
D) faleminderit
7. Formo një fjali ku mbiemri *i shkathët* të jetë përdorur në shkallën sipërore absolute. **1 pikë**

Matura Shtetërore 2006, Teste

8. Në ç' gjini janë emrat: *të folurit, të kuqtë, të zitë*? **1 pikë**
Gjinia: _____
9. Vendos në rasën rrjedhore grupin emëror të nënvizuar. Unë besoja se **klasa ime...**
Rasa rrjedhore: _____ **1 pikë**
10. Gjej fjalinë ku përemri *kush* **NUK** është përdorur drejt. **1 pikë**
A. Kë keni sjellë me vete sot?
B. A më thua dot se kush dasmor nuk është i gëzuar?
C. Të vijë me ne kush të dojë.
D. Nuk e mësova ndonjëherë se me kë më kishit ngatërruar.
11. Çfarë përemri është fjala e nënvizuar? **1 pikë**
Mori vesh se **kushdo** mund të paraqitej për të filluar punë.
Përemër: _____
12. Në cilën fjali folja *kam* është përdorur si folje ndihmëse? **1 pikë**
A) Në shtëpi kishte dy libra me përralla.
B) Nuk e di se a do të kem durim që të dëgjoj fjalën e mbylljes.
C) Më duket se kemi punuar mirë.
D) Ti duhet të kesh më shumë besim te të tjerët.
13. Në grupin e foljeve të dhëna gjej foljen që **NUK** është në të njëjtin zgjedhim me të tjerat. *them, vete, jam, bie, punoj, dua*. **1 pikë**
Folja: _____
14. Bëj shndërrimin vepror të fjalisë së mëposhtme. **1 pikë**
Ai bëhet xheloz për popullaritetin tënd. _____
15. Trego funksionin e gjymtyrëve të nënvizuara në fjalitë e mëposhtme. **3 pikë**
a. Njerëzit përreth dëgjonin **me vëmendje**. _____
b. Më pëlqen shumë të punoj **me fëmijët**. _____
c. Shtëpitë **me çati** ishin të pakta në atë qytet. _____

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

- 16.** Trego me se është shprehur kryefjala e nënvizuar. **1 pikë**
Nuk morën pjesë **të gjithë djemtë** në ndeshjen me lagjen.
Shprehur me: _____
- 17.** Gjej fjalinë e thjeshtë. **1 pikë**
A) Ky ishte i vetmi vend në botë ku atë nuk e njihnte njeri.
B) Nga lodhja dhe nga pagjumësia sytë më ishin mbyllur në një gjumë të lehtë aty në rrëzë të vaborit.
C) Sapo dëgjuan zilen, fëmijët lëshuan një psherëtimë lehtësuese.
D) Pa zbardhur mirë dita, njerëzit mbushën rrugët tamam si për festë.
- 18.** Gjej llojin e fjalisë së përbërë. **1 pikë**
Kishte fjetur aq shumë, sa iu duk një shekull.
A) Krahasore
B) Shkakore
C) Ftheluese
D) Rrjedhimore
- 19.** Vendos shkronjën s nistore aty ku duhet. **1 pikë**
A) _____ madhoj
B) _____ gavër
C) _____ filit
D) _____ verdhem
- 20.** Qarko fjalën e shkruar drejt. **1 pikë**
A) i brendëshëm
B) i brendshmë
C) i brendëshmë
D) i brendshëm
- 21.** Qarko fjalinë që ka një fjalë të shkruar gabim. **1 pikë**
A) Bregu ka shumë fshatra të bukura.
B) Ujëra të rrëmbyshme po e përmbysnin fushën.
C) Veprimi i tij ishte me të vërtetë çnjerëzor.
D) Një parandjenjë e pushtoi se ata do ta gjenin ujësjellësin.

PJESA II - LETËRSI

Heminguej: PLAKU DHE DETI (*fragment*)

Varka dridhej ende nga goditjet e peshkaqenit që hante peshkun brenda në ujë dhe plaku, duke lëshuar pëlhurën, e la varkën të kthehej mënjane, kështu që ta linte peshkaqenin të dilte sipër ujit. Kur e pa, u përkul mbi buzën e varkës dhe ia nguli thikën. Ai goditi vetëm mishin, por lëkura e trashë e peshkaqenit nuk e la thikën të futej më thellë. Plaku e goditi peshkaqenin kaq fort sa i dhembën jo vetëm duart, por edhe shpatullat. Por peshkaqeni nxori kokën nga uji dhe plaku e goditi mu në mes të kokës petashuqe, kur hunda doli nga uji që të kafshonte mishin. E nxori thikën dhe e futi për herë të dytë, po në atë vend. Peshkaqeni kishte shtrënguar fort nofullat dhe i qe kacavjerrë peshkut; plaku ia nguli thikën në syrin e majtë. Peshkaqeni s'i shqitej peshkut.

- Ashtu?- tha plaku dhe ia nguli thikën në mes të trurit dhe unazave të kurrizit. Tani kjo gjë s'ishte e vështirë dhe ndieu se thika preu kërcin. Plaku e ktheu lopatën nga ana tjetër dhe ia futi peshkaqenit në gojë, që t'ia hapte nofullat. E rrotulloi lopatën dhe, kur peshkaqeni u shkëput nga peshku tha:

- Shko poshtë, galanos. Shko poshtë një milje. Shko se e gjen atje shokun. Apo mos ishte nëna jote?

Fshiu faqen e thikës dhe e la lopatën në varkë. Pastaj rregulloi pëlhurën dhe, kur ajo gufoi nga era, e ktheu varkën në drejtimin e mëparshëm.

- Ata kanë marrë me vete sigurisht një të katërtën e peshkut, madje edhe mishin më të mirë,- tha me zë të lartë. – Sa mirë do të qe sikur kjo të ishte vetëm një ëndërr dhe të mos e kisha zënë këtë peshk! Keq më vjen, o peshk, që na ngjau kjo gjë. Na prishi shumë punë.

Plaku pushoi; ai s'kishte qejf ta vështronte peshkun tani. Ngjyra e tij i shëmbëllente ngjyrës së amalgamit me të cilën mbulojmë pasqyrën, por vijat e tij dukeshin ende.

- S'duhej të shkoja kaq larg në det, o peshk, tha. – keq më doli, edhe mua edhe ty. Keq më vjen shumë, o peshk...

Letërsi dhe gjuhë shqipe, sesioni I

Për kërkesat 22 -31 rretho vetëm shkronjën e përgjigjes së saktë.

- 22.** Në veprën “Plaku dhe deti” vëmendja e Heminguejit është drejtuar te: **1 pikë**
A) plaku Santiago.
B) djali Manolo.
C) arti i lundrimit.
D) skuadra e bejzbollit.
- 23.** Në rrëfimin e Heminguejit spikat: **1 pikë**
A) përshkrimi i tragjikes.
B) miti i Sizifit.
C) parimi i ajsbergut.
D) përshkrimi i hollësishëm.
- 24.** Gjendja psikologjike e Santiagos është: **1 pikë**
A) e gëzuar.
B) e pezmatuar.
C) e irrituar.
D) e tensionuar.
- 25.** Heminguej është shkrimtar: **1 pikë**
A) simbolist.
B) sentimentalist.
C) ekzistencialist.
D) i Brezit të Humbur.
- 26.** Në këtë prozë del natyrshëm ideja e: **1 pikë**
A) dashurisë së përjetshme.
B) luftës për ekzistencë.
C) lirisë absolute.
D) tjetërsimit të individit.
- 27.** Përqëndrohu në fragment për të portretizuar figurën e plakut Santiago. A do të ishte i motivuar ai pa luftën në det? Mendimin tënd ilustroje me detaje dhe pjesë nga fragmenti. **4 pikë**

Matura Shtetërore 2006, Teste

- 28.** Nisur nga fjalia përmbyllëse e këtij fragmenti, shpjego një nga veçoritë dalluese të stilit të Heminguejit. **3 pikë**
- 29.** Gjej dhe shpjego kuptimin e dy prej simboleve të përdorura në fragment. **4 pikë**
- 30.** Heminguej e bën plakun vazhdimisht të meditojë e të filozofojë. A mendon se autori e tepron në këtë drejtim apo është e natyrshme që një peshkatar plak të mendojë kështu pa e ditur se po filozofon? Shpreh mendimin tënd. **3 pikë**
- 31.** Kjo vepër e Heminguejit është konsideruar nga kritika si një përpjekje madhështore e njeriut për mbijetesë. Por, në këtë ndeshje ka humbës dhe fitues. A pajtohesh me këtë mendim? Argumento qëndrimin tënd duke iu referuar fragmentit ose edhe veprës në tërësi. **6 pikë**